



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

SESION INFORMUES

**LANSIMI I SKEMËS SË GRANTEVE PËR PËRKRAHJE FINANCIARE TË
NMVM-ve NË SEKTORIN E INDUSTRIJËS KREATIVE**

Në kuadër të planit të punës së Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) për vitin 2025, është planifikuar zbatimi i disa skemave të granteve për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM), të fokusuara në sektorët me vlerë të shtuar.

Njëra nga këto skema, në vlerë prej 1 milion euro, është për përkrahjen financiare të NMVM-ve që veprojnë në sektorin e Industrisë Kreative. Kjo skemë është zhvilluar në kuadër të bashkëfinancimit ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes KIESA-s dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut, e cila do të zbatohet në bashkëpunim me UNDP.

Skema për përkrahjen financiare të NMVM-ve që veprojnë në sektorin e Industrisë Kreative është adresuar për lansim në platformën e-Kosova, e cila planifikohet të shpallet me datën 04 gusht 2025.

Prandaj, me qëllim të informimit dhe udhëzimit të bizneseve për mënyrën e aplikimit, KIESA, në kuadër të MINT, së bashku me UNDP fton në sesion informues bizneset nga ky sektor, që veprimtarinë e tyre primare apo sekondare e kanë në përputhje me nën-sektorët, sipas klasifikimit të kodeve NACE, si në vijim:

- Kodi 1399 Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t
- Kodi 1512 Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësendeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve
- Kodi 2341 Prodhimi i produkteve të qeramikës për përdorim shtëpiak dhe zbukurues
- Kodi 3212 Prodhimi i stolive të çmuara dhe artikujve të ngjashëm me to
- Kodi 3213 Prodhimi i stolive imituese dhe artikujve të tjerë të ngjashëm
- Kodi 3220 Prodhimi i instrumenteve muzikore
- Kodi 5911 Aktivitetet e prodhimit të filmave, videove dhe programeve televizive
- Kodi 5912 Aktivitetet e post-produksionit të filmave, videove dhe programeve televizive
- Kodi 5920 Incizimi i zërit dhe aktivitetet e publikimit të muzikës
- Kodi 7111 Aktivitetet e arkitekturës
- Kodi 7410 Aktivitetet e specializuara të dizajnit
- Kodi 9003 Krijimtaria artistike

Shënim: Të kodet 5911 dhe 5912 përjashtohen programet televizive.

Sesioni mbahet më 05 gusht 2025, në ora 10:00, në Qendrën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës.

Singerisht,

Zef DEDAJ

U.d. i Drejtorit të Përgjithshëm i KIESA-s